

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Snezhana Mihajllloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të akuzuarit nga _____, për shkak të veprës penale asgjësimi ose dëmtimi i pasurisë nga neni 333 paragr.1 KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.2154/17 të datës 30.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më dt. 21.02.2018, në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

I pandehuri _____, nga babai _____ dhe nëna _____ e lindur _____, i lindur më dt. _____ në _____, rr. " _____ " nr. _____, ka të kryer shkollën e mesme teknike, punon si elektrikist privat, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për veprë tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse më dt. _____ rreth orës 14:40 minuta në rr. " _____ " në _____ i pandehuri _____, me dashje ka dëmtuar dhe e ka bërë të papërdorshëm pasurinë e huaj, autobusin e kompanisë " _____ " me seli në _____, me targa të regjistrimit _____, të cilin ishte duke e drejtuar vozitësi _____ nga fsh. _____, kom. e _____, në atë mënyrë që pas përfundimit të lojës së futbollit në mes të KF " _____ " dhe KF " _____ "e _____, atëherë kur tifozët e KF " _____ " me autobus po ktheheshin për në _____, në rrugëtim e sipër, i pandehuri në shenjë revolte gjuan me guri në drejtim të autobusit, me ç'rast i dëmton dhe thyen parafangon e autobusit, kështu që me i pandehuri me veprimet e veta ka asgjësuar, dëmtuar dhe bërë të papërdorshëm pasurinë e huaj, duke i shkaktuar të dëmtuarit dëm material në vlerë prej 500 €.

- me çka ka kryer veprën penale asgjësimi dhe dëmtimi i pronës nga neni 333 paragr.1 KPRK.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4,41,42,49,50,51,52, 73 dhe 74 KPRK si dhe nenit 248 dhe 365 KPPK të pandehurit i shqipton

DËNIM ME KUSHT

I. Të pandehurit i shqiptohet dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1(dy) muaji, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës kohore prej 1(një) viti, nuk kryen tjetër veprë penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të rëvokohet.

II. I dëmtuari _____ i nga fsh. _____, kom. e _____, nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale duke e konsideruar të pandehurin njeri të ndershëm dhe shpreson se me të njëjtin lehtë do të merret vesh lidhur me kompensimin e dëmit, kështu që nuk paraqet kërkesë pronëso-ro-juridike.

III. Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 25 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit. 37

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritë aktakuzën penale kundër të akuzuarit nga _____, për shkak të veprës penale asgjësimi dhe dëmtimi i pasurisë nga neni 333 paragr.1 KPRK.

Gjatë seancës fillestare të mbajtur më dt. 21.02.2018 në të cilën është lexuar aktakuza e Prokurorisë së shtetit PP.II.nr.2154/17 e dt. 30.11.2017, dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri _____ deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale e cila i vihet në barrë, duke shtuar se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale. Pasi që më parë nuk ka qenë i gjykuar ndjen se ka gabuar shumë por në ato momente ka qenë i revoltuar për shkak të lojës që e kanë humbur dhe nga këto arsye e ka gjuajtur autobusin, premtion se të dëmtuarit do t'ia kompenzon dëmin e shkaktuar, në afat prej 7 ditësh.

Në seancën e parë fillestare dhe publike, gjykatësja e vetme gjykuese mori Aktvendim me të cilin aprovoi pranimin e fajësisë, pasi që ka konstatuar se për këtë gjë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Gjykatësja e vetme ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi është bërë me vullnetin e tij, se pranimi i fajësisë përmban të gjitha faktet të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurorja nuk pati kurrfarë vërejtje lidhur me pranimin e fajësisë dhe konsideron se për këtë janë plotësuar të gjitha kushtet.

Në bazë të cekurave të mësipërme, gjykatësja e vetme gjykuese vërtetoi gjendjen faktike si vijon:

Se i pandehuri _____ ka kryer veprën penale asgjësimi dhe dëmtimi i pronës nga neni 333 paragr.1 KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me nenin 333 paragr.1 KPRK është paraparë që forma themelore e veprës penale asgjësimi ose dëmtimi i pasurisë është kur "çdo person i cili asgjëson, dëmton ose e bën të papërdorshëm pasurinë e tjetrit person, do të dënohet me dënim burgu në kohëzgjatje deri në një vit".

Në bazë të cekurave të mësipërme, gjykata vendosi që të pandehurin _____ ta shpallë fajtor për kryerjen e veprës penale, pasi që veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha elementet e veprës penale, dhe se për të njëjtat veprime është penalisht përgjegjës.

Në bazë të nenit 73 dhe 74 KPRK me rastin e shqiptimit të dënimit kundër të pandehurit, gjyqtarja e vetme gjykuese mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që nga rrethanat lehtësuese gjykata i mori parasysh pranimin e fajësisë dhe sjelljen e tij shumë korrekte ndaj të dëmtuarit, me të cilin është marr vesh lidhur me kompensimin e dëmit, kështu që i dëmtuari nuk i është

bashkëngjitur procedurës penale e as nuk ka parashtruar kërkesë pronëso-ro-juridike përmes gjykatës. 35

Sipas bindjes së kësaj gjykate shqiptimi i dënimit me kusht ndaj të pandehurit ; është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit. Gjykata konstatoi se me këtë lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit nga neni 41 KPRK që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra tjera penale, t'i parandaloj personat tjerë në kryerjen e veprave penale dhe të paraqes gjykimin shoqëror për veprën penale, të rris moralin dhe fuqizoj obligimin për të respektuar ligjin.

Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.1313/2017 më dt. 21.02.2018

Sekretarja juridike,
Suzana Kovaçević, d.v.

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Snezhana Mihajloviq, d.v.

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.

Përktheu –
Naile Keçmezi

